



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**  
**BORDI I AKREDITIMIT**

**VENDIM**

**Nr. 119, datë 20.10.2023**

**PËR**  
**AKREDITIMIN PERIODIK TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË**  
**MASTER I SHKENCAVE NË “INXHINIERI SOFTUERIKE”, TË KOLEGJIT**  
**UNIVERSITAR “INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË”**

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksonimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 11.9.2018, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2023, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “**Inxhinieri Softuerike**”, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Master i Shkencave në “**Inxhinieri Softuerike**”
- b) Cikli i studimit: Cikli i dytë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 487, datë 18.10.2012
- d) Akreditimi i parë: Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 143, datë 25.03.2016
- e) Institucioni që e ofron: Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”
- f) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Inxhinierisë Softuerike
- g) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 2 vite / 4 semestra
- h) Kredite (ECTS): 120 kredite
- i) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- j) Gjuha e mësimdhënies: Anglisht
- k) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”
- l) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 7

**pasi mori në shqyrtim:**

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- e. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- f. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;

**konstaton se:**

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimit gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuara e verifikuara përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i akreditimit të parë të këtij programi ka qënë pozitiv, pa rekomandime;
- f. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësisë të “*Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”* dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit, është **“i përmbush kryesisht standardet”**, me mangësitë si më poshtë:

1. Paqëndrueshmëri në një vështrim afatgjatë e personelit akademik me kohë të plotë, të angazhuar në këtë program studimi.
2. Mospbatim në një masë të konsiderueshme i kriterit të pranimit të përcaktuar në rregulloren e programit të studimit përse i përket notës mesatare në hyrje, gjë e cila sjell një cilësi relativisht të ulët të studentëve të pranuar.
3. Kërkimi shkencor dhe masa e financimit të tij, përfshirë aktivitetet shkencore (konferenca, etj), është në nivele të ulëta.

*Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,*









**VENDOSI:**

1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit Master i Shkencave në **“Inzhinieri Softuerike”**, të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.
2. **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **4 (katër)** vite.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **19.10.2027**.

4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### BORDI I AKREDITIMIT

SHQIPONJA TELHAJ		Kryetare
ALEXANDER KOHLER		Anëtar
AYŞEN SAVAŞ SARGIN		Anëtar
TOMASZ JELENSKI		Anëtar
IRAJ HASHI		Anëtar
MAURICE OUDEJANS		Anëtar
LEA YPI		Anëtar
KITA SALLABANDA DIAZ		Anëtar
DARINKA PIQANI		Anëtar
DRITAN NAÇE		Anëtar

INDRIT HOXHA



Anëtar

**Shënim:** Znj. Lea Ypi dhe Z. Maurice Oudejans, nuk morën pjesë në këtë mbledhje.